



Datë: 16.05.2025  
Numër Protokolli: 3238/2025

A.nr.495/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.495/2025, të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesi R.Z, kundër organit të punësimit/Komuna e Klinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.495/2025, e datës 18.03.2025, e parashtruar nga ankuesi R.Z, kështu që, **detyrohet** Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet për klasifikimin e vendeve të punës për ankuesin, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

**II. Obligohet** Kryetari i Komunës së Klinës, që të kujdeset që zbatimi i vendimit të bëhet si në pikën I.

**III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil R.Z (tutje referuar vetëm ankuesi), më datë 18.03.2025 përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos ndryshimin e koeficientit të pagës nga klasa profesional 3 në klasën profesional 2 sipas Katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 21.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa, kjo e fundit më datë 27.03.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Me tej Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendim me numër protokolli 2840/2025, të datës 29.04.2025, ka zgajtur afatin edhe për dhjetë (10) ditë pune lidhur me ankesën e ankuesit R.Z.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 177/2025 të datës 18.03.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Emalin e datës 18.03.2025 nga Zyrtari i Lartë i Personelit për ankuesin; Kopje e letërnjoftimit për R.Z; Vendimin me Nr. 08/226 të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e katalogut të vendeve të punës për shërbimin civil; Konkursi me numër reference RN00015978, i datës 06.12.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.03.2025, dërguar përmes emalit nga R.K, për Xh.D; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 495/2025, e datës 27.03.2025; Akt Emërimit 02Nr.112-29616/2024 i datës 02.09.2024; Akt Emërimit 02 Nr.112-1534/2021 të datës 01.05.2011; Diplomën me Nr. 01-454/2001 të ankuesit R.Z; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën ‘‘ Zyrtar për Gjendje Civile’’; emali i datës 14.03.2025, dërguar nga E.M, për R.Z; Lista e pagave për muajin janar të vitit 2023; Lista e pagave për muajin shkurt të vitit 2023; Lista e pagave për muajin janar të vitit 2024; Lista e pagave për muajin shkurt të vitit 2024; Lista e pagave për muajin mars të vitit 2024; Lista e pagave për muajin prill të vitit 2024; Lista e pagave për muajin maj të vitit 2024; Lista e pagave për muajin qershor të vitit 2024; Lista e pagave për muajin korrik të vitit 2024; Lista e pagave për muajin gusht të vitit 2024; Lista e pagave për muajin shtator të vitit 2024; Lista e pagave për muajin tetor të vitit 2024; Lista e pagave për muajin nëntor të vitit 2024; Lista e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024; Vendimi me numër protokolli Nr. 08/226, i datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikës së Kosovës; emali i datës 25.03.2025, dërguar nga M.B, për Xh.D.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rastin e ankuesit, është e bazuar, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedh se ankuesi sipas Akt Emërimit 02Nr.112-29616/2024, të datës 02.09.2024, është i punësuar në pozitën Zyrtar për Gjendje Civile në ZGJC Grabanicë në Komunën e Klinës në kategorinë profesionale, klasa profesional 3 me klasë dhe koeficient GJ45, 3.92.

Me tej, sipas shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi më datë 13.03.2025, përmes emalit i është drejtuar Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës që të zbatohet katalogu i ri i vendeve të punës për shërbimin civil që pozita e tij të kalojë nga klasa profesional 3 në klasën profesional 2. Njësia e Burimeve Njerëzore përmes Zyrtarit të Lartë të Personelit përmes emalit të datës 14.03.2025 ka njoftuar ankuesin se komuna ka miratuar buxhetin për vitin fiskal 2025 dhe është planifikuar për pozitën e tillë koeficienti 3.92, dhe për rrjedhojë pas miratimit të katalogut të vendeve të punës i jemi drejtuar Zyrtarit Kryesor Financiar me kërkesë për të kërkuar konfirmimin për mjete buxhetore dhe meqenëse nuk kemi marr përgjigje nuk mund të veprojmë me ndërrimin e akt emërimeve, duke e udhëzuar që mund të parashtror ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Katalogu i Vendeve të Punës në shërbimin civil parasheh pozitën e tij si kategori profesionale klasa profesional 2, nuk është zbatuar nga organi punëdhënës, duke theksuar tutje se pas miratimit të buxhetit është shpall konkursi për një pozitë të tillë në kategorinë profesionale 2. Kërkon që ankesa të aprovohet, duke e obliguar komunën e Klinës që të bëjë plotësimin e akt emërimit nga klasa profesional 3 në klasën profesional 2.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankuesit, dhe bazuar në shkresat e lëndës, rezulton fakti se pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, sipas Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve, Komuna e Klinës pozitën e ankuesit e ka propozuar në kuadër të klasës profesionale 2, mirëpo pas shqyrtimit nga Departament për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Thesari më datë 06.10.2023, pozita e ankuesit është ekuivalentuar në me klasë GJ45 dhe koeficienti 3.92. Komuna e Klinës pasi që ka përfunduar procesin e ristrukturimit, ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimin 02Nr.112-29616/2024, të datës 02.09.2024, për pozitën e njëjtë në kategorinë profesionale, klasa profesional 3 me klasë dhe koeficient GJ45, 3.92.

Qeveria e Republikë së Kosovës, sipas Vendimit me Nr. 08/226 të datës 23.10.2024, ka miratuar Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ku në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar: Obligohen të gjitha institucionet që të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës në përputhje me Rregulloren Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe këtë katalog. Rrjedhimisht sipas Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil të miratuar sipas vendimit të cekur si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas numrit rendor 1118 është paraparë pozita Zyrtar i Gjendjes Civile me kodin SHC-1118, Klasa Profesional 2 dhe në grupin e shkencave shoqërore.

Duke marr parasysh faktin se me miratimin e Katalogut të vendeve të punës për shërbimin civil, kemi rrethana të reja juridike sa i përket klasës në të cilën janë kategorizuar pozitat Zyrtar i Gjendjes Civile, me qëllim të klasifikimit të vendeve të punës, Kolegji për vendosjen e kësaj çështje juridike, ju referuar edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, respektivisht:

- Nenit 22, ku përcaktohet: *1. Çdo vend pune në shërbimin civil, është pjesë e një prej klasave në shërbimin civil të përcaktuara sipas kësaj Rregullore. 2. Çdo pozitë konkrete e kategorisë profesionale, klasifikohet si pjesë e një prej tri (3) klasave të kategorisë përkatëse. 3. Klasifikimi i një pozite në kategorinë e profesionale apo të specialistëve bëhet në bazë të procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të punës në pajtim nën 21-26 kësaj Rregulloreje.*

- Nenit 23, ku përcaktohet: *1. Klasifikimi i një vendi të punës të kategorisë së specialistëve dhe profesionale si pjesë e një prej klasave të parashikuara në nenin 14 dhe 15 të kësaj Rregullore, bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kriteret e përgjithshme të kërkuara. 12 2. Analiza e faktorëve të klasifikimit bëhet për çdo faktor mbështetur në përshkrimin e vendit përkatës të punës. 3. Karakteristikat që paraqet pozita konkrete sipas secilit faktor, krahasohen me karakteristikat e faktorëve të klasifikimit të përcaktuar për çdo klasë në pajtim me Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje. 4. Pozita vlerësohet e klasifikuar në atë klasë me karakteristikat sipas faktorëve të cilës ka më shumë ngjashmëri.*

- Nenit 24, ku përcaktohet: *Vlerësimi për klasifikimin e pozitave të punës të kategorisë të specialistëve dhe kategorisë profesionale, bëhet nga Grupi i Vlerësimit, çdo herë që përgatitet një Rregullore e organizimit të brendshëm të institucionit.*

- Nenit 25, ku përcaktohet: *1. Grupi i vlerësimit për klasifikim themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit. 2. Grupi i vlerësimit për klasifikim përbëhet nga një përfaqësues i NJMBNJ-së, dhe nga nëpunës tjerë civil me përvojë në institucionin përkatës.*

- Nenit 26, ku përcaktohet: *1. Grupi i Vlerësimit për Klasifikim analizon dhe vlerëson pozitat, harton propozimin për klasifikimin e pozitave dhe paraqet për veprime të mëtejshme tek drejtuesi më i lartë administrativ të institucionit. 2. Pas miratimit nga drejtuesi më i lartë i administrativ i institucionit, propozimi përfshihet në draftin e Rregullores së organizimit të institucionit.*

- Neni 27, ku përcaktohet: *1. Klasa të cilës i përket secila pozitë konkrete e kategorisë së specialistëve dhe profesionale, përcaktohet dhe miratohet njëkohësisht me Rregulloren për Organizim të Brendshëm të Institucionit. 2. Miratimi përfundimtar i klasifikimit të vendeve të punës ndjek procedurën për*

*propozimin dhe miratimin e Rregullores së Organizimit të Brendshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.*

Kolegji i Këshillit, referuar kuadrit ligjor të cekur si më lartë, Vendimit me Nr. 08/226 të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikë së Kosovës, për miratimin e Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, vlerëson se organi përkatës i punësimit, gjegjësisht Njësia e për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës, duhet të ndërmarr veprimet për klasifikimin e vendeve të punës për ankuesin, në pajtueshmëri me kriteret e parashikuar me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Vendimit me Nr. 08/226 të datës 23.10.2024, të Qeverisë së Republikë së Kosovës.

Kështu që thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesit vetëm në kuptim të shkeljeve procedurale, duke detyruar Kryetarin e Komunës së Klinës, që të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 13.03.2025, në pajtim më dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e shqyrtuar dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

***Këshillë juridike:*** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
***Lënda me numër A.nr.495/2025***

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit R.Z;*
- *Organit të punësimit: Kryetarit të Komunës, dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*